

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit të në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me objekt “Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare”, për periudhën 01.07.2012 deri 30.09.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 184, datë 29.12.2014.

Në mbështetje të nenit 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 184, datë 29.12.2014, dërguar z. Vasilika Vjero, Titullare e institucionit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

Gjatë ushtrimit të kompetencave të veta, QKR, krijon të ardhura nga lëshimi i dokumenteve të ndryshme, midis të cilave përmendim “Ekstraktin historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit sipas natyrës së regjistrimit”. Sipas të dhënave të regjistrit elektronik, një pjesë e konsiderueshme e shpk-ve dhe e kompanive me kapital të përbashkët apo me kapital të huaj, kanë ekstrakte historike voluminozë, që shpesh herë janë mbi 50 faqe. Konstatuam se tarifa për tërheqjen e këtij dokumentacioni është 100 lekë pavarësisht nga sasia e dokumenteve dhe numri i faqeve që tërhiqen.

Për këtë është rekomanduar:

Ngritja e një grupi pune me pjesëmarrjen e punonjësve të IT dhe Sektorit të Financës, me objekt përcaktimin e kostonë së shërbimeve shtesë, për të kërkuar ndryshimin e tarifave të shërbimit, të miratuara me VKM nr. 503, datë 01.08.2007, “Për miratimin e tarifave për shërbimet funksionale të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”, në vartësi të kostonë së përpunimit të tyre (përfshirë tarifat e regjistrimit fillestar 100 lekë). Ky ndryshim lidhet edhe me nenin 68 të ligjit “Për QKR-në”, për faktin se, subjektet private kanë akses on-line në bazën e të dhënave të regjistrit elektronik dhe dokumentet e printuara nëpërmjet web-it të QKR kanë vlerë ligjore të barabartë me kopjet që lëshon QKR konform ligjit “Për dokumentet elektronike”.

Brenda tremujorit të parë 2015

B. MASA ORGANIZATIVE.

1. Me urdhër shpenzimin nr. 173, datë 06.12.2012 është likuiduar shoqëria “Communication Progres” shpk në vlerën prej **472,000 lekë** me objekt “Up grade i shërbimit Lan-To-Lan”, për rritjen e shpejtësisë së lidhjeve të sporteleve dhe zyrës qendrore me njësite periferike duke kaluar nga shpejtësia 384 kbps në 512 kbps dhe nga 10 Mbps në 20 Mbps. Në dokumentacionin bashkëlidhur kësaj pagese, nuk u gjend asnjë dokument i hartuar nga sektori i informatikës që të justifikonte rritjen e shpejtësisë së shërbimit Lan-To-Lan, si pasojë e rritjes së volumit të punës apo fluksin e trafikut në sportelet dhe zyrat qendrore dhe rajonale. Nga verifikimi i kryer për këtë qëllim, grupi i auditimit nuk mundi të provonte në se shërbimi kishte këtë shpejtësi, pasi mungonte monitorimi dhe dokumentimi i bandwidth-it, në mënyrë të vazhdueshme nga grupi i monitorimit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Grupi i monitorimit të kontratës, duhet të marrë masa për Monitorimin e të gjitha shërbimeve sipas kontratës, përfshirë këtu edhe bandwidth-in (detajuar sipas download/upload). Testimet nga grupi i monitorimit të jenë të vazhdueshme si dhe të dokumentuara me të gjitha detajet e plota.

Vazhdimisht

2. Për periudhën objekt auditimi, QKR ka lidhur kontratë me shoqërinë “”, me kohëzgjatje deri në datën 20.03.2016 në vlerën totale prej **35,758,000 lekë** me objekt “*Mirëmbajtje e sistemeve*”

informative të QKR-së”, duke likuiduar periodikisht për çdo muaj vlerën prej 827,234 lekë. Në nenin 41, pika 41.2, të kësaj kontrate është përcaktuar se; “Furnizuesi do t’i faturojë porositësit çmimin e mirëmbajtjes ekuivalente në shumën që i takon të shpenzojë çdo muaj”, brenda kësaj vlere do të përfshihet edhe zëri i shpenzimeve me emërtimin “zhvillime të reja” në masën 20% të vlerës së shpenzimit mujor sipas kontratës, ose në vlerën prej 137,000 lekë në muaj. Nga auditimi i këtij shpenzimi u konstatua se, likuidimet janë kryer në mënyrë sistematike për çdo muaj në vlerën prej 827,234 lekë, pa evidentuar në mënyrë analitike dy kategoritë e shërbimit, respektivisht shërbimin bazë në masën 80 % dhe shpenzimet e tjera me emërtimin “zhvillimet e reja” të kryera deri në masën 20 % të vlerës mujore sipas nenit 41 të kontratës, veprim i cili është në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007. Mos pasqyrimi në mënyrë analitike dhe të qartë të shërbimit të kryer me objekt “zhvillimet e reja të sistemit”, të cilat sipas kontratës janë programuar në vlerën prej **3,151,000 lekë** (23 muaj x 137,000), krijon mundësi që shoqëria sipërmarrëse nëpërmjet mosdokumentimit në mënyrë analitike të shpenzimeve të realizojë të ardhura të pamërituara. **Për këtë është rekomanduar:**

Ngritja e një grupi pune me pjesëmarrjen e punonjësve të informatikës me qëllim monitorimin e tarifës së këtij shërbimi dhe pasqyrimin për çdo muaj të sasisë mujore të shërbimit “zhvillime të reja”, me qëllim, pasqyrimin real të këtij shërbimi në sasi dhe në vlerë, konform nenit 41.2 të kontratës së lidhur midis palëve.

Brenda tremujorit të parë 2015

3. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, për periudhën objekt auditimi, urdhër shpenzimet dhe dokumentacioni bankar, në cilësinë e firmës së parë janë nënshkruar nga ish Drejtori i Përgjithshëm z. [REDAKTUAR] dhe në cilësinë e firmës së dytë të nëpunësit zbatues për periudhën deri në datën 4 prill 2014 janë nënshkruar nga znj. [REDAKTUAR], dhe për periudhën prill 2014 e në vazhdim janë nënshkruar nga zonja [REDAKTUAR]. Këta punonjës sipas akteve të emërimit janë specialiste të financës, pra nuk kanë vartësi direkt nga Drejtori i Përgjithshëm, veprim i cili është në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. **Për këtë është rekomanduar:**

Marrja e masave për të caktuar nëpunësin zbatues, i cili duhet të jetë nivel menaxherial në vartësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm. Gjithashtu, Përgjegjësi i Sektorit Financiar duhet të ushtrojë funksionin e planifikimit, monitorimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetin si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara të njësisë në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi.

Menjëherë

4. Nga auditimi konstatohet se, aktivet qarkulluese sipas bilancit kontabël paraqiten në vlerën prej 3,605,240 lekë, ndërsa gjendja fizike e tyre sipas të dhënave të inventarit fizik është në vlerën prej 3,639,114 lekë, pra gjendja fizike rezulton 33,874 lekë më e madhe se gjendja kontabile. **Për sistemimin e këtij veprimi është rekomanduar:**

Kalimi i tepricës në vlerën 33,874 lekë, në llogarinë e fondeve bazë.

Brenda datës 31.12.2014

5. Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve dhe pasqyrave financiare, u konstatua se, disa artikuj në vlerën totale prej 505,000 lekë nuk ishin pasqyruar në fletën e inventarit në kolonën “gjendje fizike dhe në mënyrë të padrejtë janë kontabilizuar në llogarinë 602 (shpenzime të përgjithshme), dhe jo në llogarinë “objekte inventari”, veprim i cilin ngarkon me përgjegjësi ish përgjegjësen e financës. **Për sistemimin e këtij veprimi është rekomanduar:**

Kryerja e inventarit fizik në fund të vitit 2014 dhe evidentimin e të gjithë materialeve që janë objekt inventari me qëllim sistemimin e llogarisë 32 “Objekte inventari” në kredi të llogarisë 101 “Fonde bazë” dhe për diferencat e mundshme të nxirret përgjegjësia.

Brenda datës 31.12.2014

6. Nga auditimi i kryer në inventarët periodikë të magazinës respektivisht për vitet 2012 dhe 2013, u konstatuan se, disa mallra paraqiteshin në kartelat e magazinës me gjendje në sasi të mëdha, gjë që

tregon për furnizime tepër të larta krahasuar me ritmin e përdorimit të tyre, kështu, në datën 31.12.2012 janë gjendje në magazine 5,170 copë mandat-arkëtimi në vlerën prej 620,400 lekë, sasi që paraqitet e pandryshuar edhe në datën 30.09.2014 duke e konsideruar këtë artikull “stok”. Aktualisht përdorimi i tyre është i pamundur pasi, për çdo veprim që bëjnë subjektet private në QKR, pagesat i kryejnë direkt në sporteleve të bankave, pa komision. Në datën 31.12.2012 janë gjendje 4,690 copë CD në vlerën prej 281,400 lekë dhe në datën 31.12.2013 gjendja e tyre është 4,390 copë, gjë që tregon për ritëm të ulët në përdorimin e tyre. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa për një planifikim të drejtë të nevojave për artikuj inventari në mënyrë që ti prihet rruga praktikave abuzive të deritanishme. Të mundësohet kalimi i artikujve me qarkullim të ngadalshëm në subjekte të tjera shtetërore brenda ministrisë së linjës ku ka mundësi përdorimi për këto lloj artikujsh.

Në vazhdimësi

7. Në zbatim të ligjit nr. 38/2012, datë 05.04.2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, QKR ka kryer shpenzime për hartimin e programit me objekt “Implementimin e formularëve dhe përgatitjen e infrastrukturës së regjistrimit elektronik të shoqërive”, në vlerën prej **2,496 mijë lekë**. Nga verifikimi për efektivitetin e këtij shërbimi konstatohet se prej ditës së hyrjes në funksion të këtij programi viti 2012 dhe deri në datën 30.06.2014, janë regjistruar gjithsej 50 shoqëri bujqësore. **Për të rritur efektivitetin e këtij shpenzimi është rekomanduar që:**

QKR në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të gjej dhe aplikojë mjete të efektshme jo vetëm për identifikimin e shoqërive të reja bujqësore por edhe sensibilizimin e fermerëve për të regjistruar shoqëritë e krijuara në regjistrin elektronik të QKR.

Në vazhdimësi

8. Nga auditimi i veprimeve dhe dokumentacionit të QKR-së mbi llogaritjen e fondit limit për prokurimin e mallrave e sidomos të shërbimeve, është konstatuar që nuk bëhet analizë e elementëve të shpenzimeve që përbëjnë objektin e tenderimit, studimi i tregut është formal, duke marrë oferta shpesh të parregullta nga operatorë ekonomik që ushtrojnë aktivitet në fushën përkatëse. Kjo ka bërë që fondi limit i përlllogaritur, në disa raste ka qenë lart (me shumë rezerva), në raste të tjera fondet e përlllogaritura, nuk kanë mbuluar shpenzimet ligjore (tek prokurimi i rojeve private) etj. **Për të eliminuar këto parregullsi është rekomanduar që:**

AK në çdo rast tenderimi, përpara përgatitjes dhe nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, të analizojë koston e mallrave, shërbimeve e punëve që do prokurohen, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike dhe nxitjen e konkurrencës në tenderim.

Në vazhdimësi

9. Në tenderët e zhvilluar për shërbimin e lidhjeve online të QKR qendër me degët, të krijimit të sistemeve me bazë pajisjet elektronike, u konstatua se, Autoriteti Kontraktor, ka përcaktuar një numër të madh e të paargumentuar të kërkesave të veçanta për kualifikim, duke sjellë pengesa të panevojshme konkurruese për operatorët ekonomik pjesëmarrës në tender, anulime të procedurave, vonesa e vështirësi për marrjen e shërbimit të kërkuar. Kjo mënyrë ka krijuar në mënyrë artificiale “*kushte emergjence*” për Autoritetin Kontraktor, për të përdoruar nga QKR forma prokurimi pak efektive, si procedurën me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës. **Për këtë është rekomanduar që:**

QKR si Autoritet Kontraktor, në komisionet e përgatitjes së dokumenteve të tenderit dhe të specifikimeve teknike, të vendosi specialistë me njohje të gjerë të legjislacionit të fushës përkatëse. Të bëhet kujdes që, vendosja e kërkesave specifike për kualifikimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në tender, të jenë të argumentuara dhe gjithnjë në përpjesëtim e të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit.

10. Nga auditimi për zbatimin e rregullave për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratave, u konstatua se: Titullarët e Autoritetit Kontraktor kanë caktuar për çdo kontratë të lidhur, personin apo personat që mbikëqyrin e i monitorojnë ato. Personat e ngarkuar me monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratave, nuk kanë plotësuar dokumentacionin e duhur, për të vërtetuar plotësimin e detyrimit të operatorëve ekonomik, sipas specifikimeve në kontratë. Në përfundim të kontratave, autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur raport përmblledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, duke mos zbatuar në këtë mënyrë pikën 2/b, Kreu VIII, të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Si rrjedhojë e kësaj mangësie subjekti “**██████████**”, ka përfituar padrejtësisht vlerën prej **540,279 lekë** pasi “Shërbimi për mirëmbajtjes dhe përmirësimit të infrastrukturës së IT lokale”, nuk rezulton të jetë kryer dhe dokumentuar sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur me objekt: “***Për shërbimet LAN TO LAN për lidhjen e degëve të QKR me QKR Qendër, mirëmbajtjen e këtyre lidhjeve, ofrimin e shërbimit të internetit e shërbimeve të tjera të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike***”.

Për këto mangësi është rekomanduar që:

Monitorimi i kontratës LAN to LAN të realizohet dhe dokumentohet sipas çdo shërbimi të kryer, çka do të thotë se ky monitorim duhet të japë informacion për linjat up/down, ndërprerjen në kohë, raportimin dhe ndjekjen e zgjidhjen e incidenteve, si dhe monitorimin e shpejtësisë së bandwidthit (e detajuar në Upload/Download), shërbimet e kryera në mënyrë të detajuar për përmirësimin e infrastrukturës së IT lokale, shërbimet e kryera në mënyrë të detajuar për publikimin online, për të përcaktuar nëse projekti është në rrugë të mirë drejt arritjes së rezultateve të parashikuara.

Menjëherë

C.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në nenin 27, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës” me ndryshimet e mëvonshme, të nxirren urdhrat për shpërblim dëmi, të kryen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat si më poshtë:

1. Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **8,208,000 lekë**, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për sa skualifikuar në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik me vlerë më të ulët në tenderin e zhvilluar me objekt “***Për shërbimet LAN TO LAN për lidhjen e degëve të QKR me QKR Qendër, mirëmbajtjen e këtyre lidhjeve, ofrimin e shërbimit të internetit e shërbimeve të tjera të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike***”.

Menjëherë

2. Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **540,279 lekë** nga shoqëria “**██████████**”, pasi “Shërbimi për mirëmbajtjes dhe përmirësimit të infrastrukturës së IT lokale”, nuk rezulton të jetë kryer dhe dokumentuar sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur me objekt: “***Për shërbimet LAN TO LAN për lidhjen e degëve të QKR me QKR Qendër, mirëmbajtjen e këtyre lidhjeve, ofrimin e shërbimit të internetit e shërbimeve të tjera të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike***”.

Menjëherë

3. Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **480,000 lekë**, respektivisht nga ish Drejtori z. **██████████** dhe **██████████** në cilësinë e punonjës zbatues dhe Përgjegjëse e Sektorit të Financës, për sa likuiduar një subjekt për trajnimin e punonjësve, pagesë e cila është e pajustificuar me dokumente ligjore, në kundërshtim me ligjin 10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollim, neni 4, pika 26.

Menjëherë

4. Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **200,000 lekë**, respektivisht nga ish Drejtori z. [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në cilësinë e punonjës zbatues dhe Përgjegjës e Sektorit të Financës, për sa kryer pagesa për blerje materiale të ndryshme, e cila është e paargumentuar dhe e pajustificuar.

Menjëherë

6. Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **65,880 lekë** respektivisht 21,960 lekë, nga ish Drejtori z. [REDAKTUAR], në cilësinë e nëpunësit autorizues ish përgjegjës e financës [REDAKTUAR] dhe zonja [REDAKTUAR] në cilësinë e nëpunës zbatues, për sa paguar kushte penale për mos likuidim në afat të faturave të shpenzimeve të telefonisë fikse ndaj shoqërisë "[REDAKTUAR]".

Menjëherë

7. Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **14,820 lekë** respektivisht nga [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] për sa nënshkruar faturën për "Shërbim konfigurimi dhe instalim printer të portave të USB" nga një subjekt privat, ndërkohë që në cilësinë e specialistëve të informatikës ky shërbim është detyrë funksionale e tyre.

Menjëherë

8. Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **9,498 lekë** respektivisht nga [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për sa nënshkruar fletëdaljen e magazinës për tërheqjen e pajisjes "Linksys Wireless-G broadband Router", e cila nuk rezultoi të jetë pasqyruar në gjendjen kontabile dhe gjendjen fizike në inventarin e kryer në fund të vitit 2012, trajtuar më hollësisht në faqen 75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

D.MASA DISIPLINORE

D.1. Mbështetur në nenin 58 pika "d" të ligjit nr. 152/2013 "Statusi i nëpunësit civil", miratuar në datën 13.05.2013 dhe kreu II i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", kërkoj të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, "Largim nga shërbimi civil", për Znj. [REDAKTUAR], në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Drejtore e IT në QKR, pasi:

Në procedurën e tenderit të hapur, të zhvilluar në vitin 2014 me objekt "Për shërbimet LAN TO LAN për lidhjen e degëve të QKR me QKR Qendër, mirëmbajtjen e këtyre lidhjeve, ofrimin e shërbimit të internetit e shërbimeve të tjera të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike", për sa **skualifikuar në në mënyrë të padrejtë dhe të paargumentuar, Operatorin ekonomik "[REDAKTUAR] [REDAKTUAR]" & "[REDAKTUAR] [REDAKTUAR]", duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën prej 8,208,000 lekë pa TVSH, e konkretisht:**

Nuk ka paraqitur **"Formularin e informacionit konfidencial"**, ky argument është i pambështetur në ligjin dhe rregullat e Prokurimit Publik, pasi: Ky formular nuk është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, të renditur në kreun III të VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, nuk është as pjesë e Informacionit të përgjithshëm dhe as e "Informacion specifik", e për rrjedhojë nuk është formular detyrues për t'u plotësuar nga OE. Në krye të formularit, në kllapa, është venë shënimi: "Shënimi më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial", që do të thotë se mund të plotësohet ose jo. Plotësimi apo jo i formularit nuk heq detyrimin e AK për të ruajtur integritetin e të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje në prokurim. Në rastin konkret, mosparaqitja e formularit të plotësuar e të firmosur nga OE, do të thotë se ky i fundit nuk ka dashur të paraqesë informacione që të mbahen

konfidenciale nga AK. Edhe operatorët e tjerë pjesëmarrës në tender, këtë formular e kanë paraqitur të paplotësuar, që do të thotë se nuk kanë paraqitur informacione që kërkojnë të mbahet konfidencial nga autoriteti kontraktor. Këto fakte nënkuptojnë se ky dokument është formal, ndërsa autoriteti kontraktor e ka përdorur për qëllime skualifikuese.

Operatori ekonomik “[REDAKTUAR]”, është skualifikuar në mënyrë të padrejtë me arsyetimin se, nuk ka pronësinë e rrjetit të fibrave optike, apo marrje me qira të fibrave optike për të realizuar lidhjen e QKR qendër me degët rajonale. Ndërkohë që Operatori ekonomik e plotëson këtë kërkesë, pasi në përgjigjen e dhënë nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me shkresën nr.611/1 prot, datë 13.03.2014, është shprehur se: “[REDAKTUAR]” shpk ka gjithashtu “rrjete aksesit përcjellësish fibër optike të vetin dhe me qira nga Albtelecom, ATU, ABCOM, radio të vetin, me rrjete transmetimi fibër optike të marrë me qira nga Albtelecom. Brezi i frekuencave në të cilin operojnë radio segmentet e rrjetit të aksesit 2,4 dhe 5 GHz. Këto rrjete mundësojnë ofrimin e shërbimit të transmetimit të të dhënave në vendndodhje fikse dhe broadband”. Në zgjidhjen teknike të paraqitur nga operatori “[REDAKTUAR]” ka deklaruar se lidhjet do të bëhen me fibër optike (lidhja primare) dhe SHDSL (backup.)

Gjithashtu, në asnjë dokument të AK, nuk është kërkuar në mënyrë specifike që ofertuesit të shprehen për pronësinë apo qiranë e rrjetit me të cilën do realizojnë këtë lidhje. Gjithashtu theksojmë se, ky operator ekonomik, ka përfunduar kontratën e mëparshme të lidhur me QKR-në për një afat 5 vjeçar, për të cilën nga Autoriteti Kontraktor nuk ka patur asnjë pretendim për cilësinë e shërbimit dhe e ka përmbytur atë me sukses.

D.2.Mbështetur në nenin 58 pika “d” të ligjit nr. 152/2013 “Statusi i nëpunësit civil”, miratuar në datën 13.05.2013 dhe kreu II i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, rekomandoj masën disiplinore: “Largim nga shërbimi civil” për:

1. Z. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish Kryetarit të i AK, i larguar nga detyra, pasi nuk ka zbatuar detyrimet për ngritjen dhe funksionimin e komisionit për vlerësimin dhe përlllogaritjen e fondit limit në tenderët me negociim pa shpallje paraprake për marrjen e shërbimit LAN to LAN të vitit 2013, duke mos zbatuar kërkesat e nenit 28/1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ku shprehet: “Përcaktimi i vlerës së një kontrate publike bazohet në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH, të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor në çastin e botimit të njoftimit të kontratës...ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një botim i tillë”. Dhe me kreun II, pika 2, germa “ç” të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet: “Autoriteti kontraktor, në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, analizon koston e mallrave, të shërbimeve dhe punëve që prokurohen.....”.

Për marrjen e shërbimit LAN to LAN në QKR, për periudhën e vitit 2013, janë zhvilluar procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në mënyrë të paargumentuar në bazën ligjore, pasi shkaku i dështimit të procedurave të hapura ka qenë vetë Autoriteti Kontraktor.

Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Blerje serveri**”, me Urdhër Prokurimi nr.95, datë 5.06.2013, me fond limit pa tvsh 3,750,000 lekë, është ndryshuar objekti i prokurimit nga blerje “**Pajisje kompjuterike dhe server**” në “**Blerje serveri**”, duke rritur artificialisht fondin limit të kësaj procedure.

Në cilësinë e ish titullarit të QKR-së, ka nënshkruar urdhrat e prokurimit, në të cilat ka mbizotëruar forma e prokurimit “Ftesa me negociim pa botimin paraprak të njoftimit të kontratës”, duke e argumentuar këtë me emergjencën e krijuar për shërbime e mallra. Nga analiza e hollësishme të procedurave të prokurimit të zhvilluara në vitin 2013, u konstatua se, në dokumentet e tenderit, janë vendosur kërkesa kualifikuese të paargumentuara që kanë sjellë dështime të procedurave prokuruese,

për të cilët në cilësinë e Titullarit nuk ka marrë masa për eliminimin e parregullsive, për faktin se këto emergjenca janë krijuar në mënyrë artificiale nga vetë Autoriteti Kontraktor.

Ka nënshkruar urdhër shpenzime për blerje mallra dhe materiale më tepër se kërkesat për përdorimin e tyre duke rritur mënyrë të paargumentuar gjendjen e mallrave stok, gjë që tregon për përdorim pa efektivitet të fondeve publike

Nuk ka marrë masa për likuidimin në afat faturat e energjisë elektrike për 15 muaj rresht, në vlerën prej 3,521,150 lekë, duke sjellë si pasojë që nëpërmjet likuidimit të tyre të menjëhershëm të vështirësohet aktiviteti ekonomik-financiar, deri edhe në pagimin e kamatëvonesave për shërbimin e telefonisë fikse, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

2. Znj. [REDAKTUAR], ish financiere, në cilësinë e anëtares së komisionit të përlllogaritjes së fondit limit në tenderin me objekt “Për shërbimet LAN TO LAN për lidhjen e degëve të QKR me QKR Qendër, mirëmbajtjen e këtyre lidhjeve, ofrimin e shërbimit të internetit e shërbimeve të tjera të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike”, pasi:

Në cilësinë e anëtarit për studimin e tregut në llogaritjen e fondit limit, ka pranuar ofertat të parregullta, pa datën e përgatitjes nga operatorët ekonomik, duke mos përcaktuar në këtë mënyrë kohën kur ato i janë paraqitur autoritetit kontraktor për llogaritjen e fondit limit, parregullsi e cila e ngarkon me përgjegjësi;

Në cilësinë e Përgjegjëses së Financës dhe nëpunëse zbatuese, ka vepruar në kundërshtim me planin kontabël në evidentimin e shpenzimeve për shërbime dhe blerje të vlerave materiale duke i kaluar në shpenzime të përgjithshme dhe jo në llogaritë inventariale, ka lejuar pagimin e kamatëvonesave në likuidimin e faturave të Albtelekom, duke i kontabilizuar në shpenzime, ndërkohë që duhej nxjerrë përgjegjësia personale. Në bilancin kontabël të vitit 2012 llogaritë analitike të vlerave materiale nuk rakordojnë me llogarinë sintetike të bilancit kontabël;

Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve dhe pasqyrave financiare, u konstatua se, disa artikuj në vlerën totale prej 505 mijë lekë nuk ishin pasqyruar në fletën e inventarit në kolonën “gjendje fizike” dhe në mënyrë të padrejtë janë kontabilizuar në llogarinë 602 (shpenzime të përgjithshme), dhe jo në llogarinë 32 “objekte inventari”;

Ka nënshkruar urdhër shpenzime për blerje mallra dhe materiale më tepër se kërkesat për përdorimin e tyre duke rritur mënyrë të paargumentuar gjendjen e mallrave stok, gjë që tregon për përdorim pa efektivitet të fondeve publike;

Në cilësinë e nëpunëses zbatuese, nuk ka marrë masa për likuidimin në afat të faturave të energjisë elektrike për 15 muaj rresht, në vlerën prej 3,521,150 lekë, duke sjellë si pasojë që nëpërmjet likuidimit të menjëhershëm të vështirësohet aktiviteti ekonomik-financiar, deri edhe në pagimin e kamatëvonesave për shërbimin e telefonisë fikse, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Duke qenë se nënpunësit janë të larguar nga detyra i kërkojmë Institucionit që “Të njoftohet Departamenti i Administratës Publike për masën e rekomanduar”.

D.3. Mbështetur në nenin 58 të ligjit nr. 152/2013 “Statusi i nëpunësit civil”, miratuar me datë 13.05.2013 dhe kreu II i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për shkëljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për këtë i rekomandojmë Titullarit të Institucionit marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Në mos ngritjen në detyrë”, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. [REDAKTUAR], me detyrë specialist i IT në QKR, në rolin e anëtarit të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit në tenderin me objekt “Për shërbimet LAN TO LAN për lidhjen e degëve të QKR me

QKR Qendër, mirëmbajtjen e këtyre lidhjeve, ofrimin e shërbimit te internetit e shërbimeve të tjera të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike”, pasi:

Në cilësinë e anëtarit për studimin e tregut për llogaritjen e fondit limit, ka pranuar ofertat të parregullta, pa datën e përgatitjes nga operatorët ekonomik, duke mos lejuar përcaktimin e kohës kur ato i janë paraqitur autoritetit kontraktor për llogaritjen e fondit limit, parregullsi e cila e ngarkon me përgjegjësi.

Në tenderin me objekt “Shërbimi i ruajtjes me roje private të QKR-së”, në rolin e anëtarit të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, nuk ka zbatuar bazën ligjore të prokurimit, për të bërë një analizë të elementëve të shpenzimeve për realizimin e shërbimit të kërkuar si shpenzimet e detyrueshme ligjore për pagat, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat dhe shpenzimet e tjera që duhet të bëhen për zhvillimin e aktivitetit si për armëmbajtje, shpenzime veshmbathje të rojeve, të komunikimit etj.

2. Znj. [REDAKTUAR], me detyrë juriste, në rolin e anëtarit të njësisë së prokurimit në tenderin me objekt “Për shërbimet LAN TO LAN për lidhjen e degëve të QKR me QKR Qendër, mirëmbajtjen e këtyre lidhjeve, ofrimin e shërbimit te internetit e shërbimeve të tjera të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike”, pasi:

Nuk ka zbatuar rregullat për përgatitjen e dokumenteve të tenderit, sidomos në argumentimin e kërkesave të veçanta për kualifikim;

Në tenderin me objekt “Ndërtimi i sistemit të aplikimeve online për QKR”, nuk është marrë miratimi i dokumentacionit për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore në kundërshtim me nenin 7, të VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”;

Përgatitja e dokumenteve të tenderit nuk është mbështetur në dokumentet standarde të tenderit, duke mos zbatuar kërkesat e përcaktuara në Kreun III (Dokumentet e Tenderit), pika 1, germa “a”, përcaktohet: “...Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit...”.

3. Znj. [REDAKTUAR], me detyrë juriste, në rolin e anëtarit të njësisë së prokurimit në tenderin me objekt “Për shërbimet LAN TO LAN për lidhjen e degëve të QKR me QKR Qendër, mirëmbajtjen e këtyre lidhjeve, ofrimin e shërbimit te internetit e shërbimeve të tjera të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike”, pasi:

Nuk janë zbatuar rregullat për përgatitjen e dokumenteve të tenderit, sidomos në argumentimin e kërkesave të veçanta për kualifikim;

Në tenderin me objekt “Ndërtimi i sistemit të aplikimeve online për QKR”, nuk është marrë miratimi i dokumentacionit për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore në kundërshtim me nenin 7, të VKM nr.945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”;

Përgatitja e dokumenteve të tenderit nuk është mbështetur në dokumentet standarde të tenderit, duke mos zbatuar kërkesat e përcaktuara në Kreun III (Dokumentet e Tenderit), pika 1, germa “a”, përcaktohet: “...Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit...”.

4. Znj. [REDAKTUAR], me detyrë inxhinierë e IT, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit në tenderin me objekt “Për shërbimet LAN TO LAN për lidhjen e degëve të QKR me QKR Qendër, mirëmbajtjen e këtyre lidhjeve, ofrimin e shërbimit te internetit e shërbimeve të tjera të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike”, nuk janë zbatuar rregullat për përgatitjen e dokumenteve të tenderit, sidomos në argumentimin e kërkesave të veçanta për kualifikim.

Në tenderin me objekt “Ndërtimi i sistemit të aplikimeve online për QKR”, nuk është marrë miratimi i dokumentacionit për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore në kundërshtim me nenin 7 të VKM nr.945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”;

Përgatitja e dokumenteve të tenderit nuk është mbështetur në dokumentet standarde të tenderit, duke mos zbatuar kërkesat e përcaktuara në Kreun III (Dokumentet e Tenderit), pika 1, germa “a”, përcaktohet: “...Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit...”.

5. Znj. [REDAKTUAR] dhe Znj. [REDAKTUAR], punonjëse të QKR, të ngarkuara nga Titullari i Autoritetit Kontraktor për shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomik, pasi:

Në konkluzionet dhe relacionet e përgatitura për titullarin e AK, nuk janë bazuar në analizën mbi zbatimin ose jo të legjislacionit të mësipërm, në zbatimin e kërkesave të AK parashtruar në dokumentet e tenderit, nuk kanë analizuar dhe ballafaquar vlerësimet e KVO me bazën ligjore si Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, VKM mbi pagën minimale, ligjin mbi sigurimet shoqërore e shëndetësore, Urdhrat e Ministrit të Brendshëm për normativat e shpenzimeve për veshmbathjen, armatimin apo ndërlidhjen që përdoret nga firmat private të ruajtjes e sigurisë së personave e objekteve.

Shënim:

Bazuar në shkeljet të natyrës procedurale teknike të konstatuara dhe të referuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për personat përgjegjës Z. [REDAKTUAR], Z. [REDAKTUAR], Z. [REDAKTUAR], Z. [REDAKTUAR] dhe Znj. [REDAKTUAR] të cilët janë të larguar nga Institucioni nuk po shprehem për masën disiplinore që ne gjykonim se i takonte nga “Ulja në pagë për një periudhë deri në 6 muaj” deri në “Mosngritjen në detyrë”.

E. MBI SHËRBIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT.

Nga Auditimi i kryer në QKR për “Ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare”, u konstatuan risqe në fushën e Teknologjisë së Informacionit, të lidhura me mungesa në përshkrimin e detajuar për çdo punonjës të IT, apo ndarje operationale e punëve dhe detyrave në institucion për këtë drejtori. Institucioni nuk kryen procesin e vlerësimit të kërkesave dhe nevojave. Në kontratat e lidhura nuk përcaktohen TKP (Tregues Kyç të Performancës) dhe si rrjedhojë nuk kontrollohen dhe monitorohen si duhet kontratat e lidhura për këtë shërbim. Mungojnë analizat për monitorimin, raportimin dhe zgjidhjen e incidenteve. Nuk ka gjurmë të realizimit të testeve për back-up dhe nuk kanë Business Continuity Plan dhe Disaster Continuity plan.

Bazuar në sa kemi konstatuar rekomandojmë auditim të plotë brenda vitit 2015 të sistemeve të IT në institucionin e QKR-së në mënyrë që të arrijmë të japim sigurinë e plotë që këto sisteme plotësojnë dhe janë në funksion të arritjes së objektivave kryesore të këtij institucioni.

F. KALLËZIM PENAL

Për të meta, mangësi dhe shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik të konstatuara në auditimin e kryer në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të kallëzohen në Prokurori znj. [REDAKTUAR] në cilësinë e kryetares së KVO dhe z. [REDAKTUAR] në cilësinë e Titullarit të për shkeljet e konstatuara si më poshtë shkeljet e konstatuara si më poshtë:

Znj. [REDAKTUAR], Drejtore e IT në QKR, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e hapur me objekt: “Për shërbimet LAN TO LAN për lidhjen e degëve të QKR me QKR Qendër, mirëmbajtjen e këtyre lidhjeve, ofrimin e shërbimit të internetit e shërbimeve të tjera të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike” pasi; kanë skualifikuar operatorin ekonomik “[REDAKTUAR]”

██████████” shpk, në mënyrë të paargumentuar ndonëse ka paraqitur ofertën më të ulët, me arsyetimet e mëposhtme:

1. Nuk ka paraqitur **“Formularin e informacionit konfidencial”**. Shkak i pambështetur në bazën ligjore Ligjin e rregullat e Prokurimit Publik, pasi: *Ky formular nuk është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, të renditur në kreun III të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, nuk është as pjesë e Informacionit të përgjithshëm dhe as e “Informacion specifik”, e për rrjedhojë nuk është formular detyrues për t’u plotësuar nga OE. Në krye të formularit, në kllapa, është venë shënimi: “Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial”, që do të thotë se mund të plotësohet ose jo. Plotësimi apo jo i formularit nuk heq detyrimin e AK për të ruajtur integritetin e të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje në prokurim. Në rastin konkret, mosparaqitja e formularit të plotësuar e të firmosur nga OE, do të thotë se ky i fundit nuk ka dashur të paraqesë informacione që të mbahen konfidenciale nga AK. Edhe operatorët e tjerë pjesëmarrës në tender, këtë formular e kanë paraqitur të paplotësuar, që do të thotë se nuk kanë paraqitur informacione që kërkojnë të mbahet konfidencial nga autoriteti kontraktor. Këto fakte nënkuptojnë se ky dokument është formal, ndërsa autoriteti kontraktor e ka përdorur për qëllime skualifikuese.*

2. Operatori ekonomik “██████████”, është skualifikuar në mënyrë të padrejtë me arsyetimin se, nuk ka pronësinë e rrjetit të fibrave optike, apo marrje me qira të fibrave optike për të realizuar lidhjen e QKR qendër me degët rajonale. Ndërkohë që Operatori ekonomik e plotëson këtë kërkesë, pasi në përgjigjen e dhënë nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me shkresën nr.611/1 prot, datë 13.03.2014, është shprehur se: “██████████” shpk ka gjithashtu “rrjete aksesit përcjellësish fibër optike të vetin dhe me qira nga Albtelecom, ATU, ABCOM, radio të vetin, me rrjete transmetimi fibër optike të marrë me qira nga Albtelecom. Brezi i frekuencave në të cilin operojnë radio segmentet e rrjetit të aksesit 2,4 dhe 5 GHz. Këto rrjete mundësojnë ofrimin e shërbimit të transmetimit të të dhënave në vendndodhje fikse dhe broadband”. Në zgjidhjen teknike të paraqitur nga operatori “██████████” ka deklaruar se lidhjet do të bëhen me fibër optike (lidhja primare) dhe SHDSL (backup.)

Gjithashtu, në asnjë dokument të AK, nuk është kërkuar në mënyrë specifike që ofertuesit të shprehen për pronësinë apo qiranë e rrjetit me të cilën do realizojnë këtë lidhje. Gjithashtu theksojmë se, ky operator ekonomik, ka përfunduar kontratën e mëparshme të lidhur me QKR-në për një afat 5 vjeçar, për të cilën nga Autoriteti Kontraktor nuk ka patur asnjë pretendim për cilësinë e shërbimit dhe e ka përmbyshur atë me sukses.

Për skualifikimin e padrejtë dhe të paargumentuar, komisioni i vlerësimit të ofertave ka favorizuar në mënyrë të padrejtë Operatorin ekonomik “██████████” & “██████████”, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën prej 8,208,000 lekë pa TVSH.

Z. ██████████, në cilësinë e Kryetarit të Autoritetit Kontraktor pasi për vitin 2013:

Nuk ka zbatuar detyrimet për ngritjen dhe funksionimin e komisionit për vlerësimin dhe përllogaritjen e fondit limit në tenderët me negociim pa shpallje paraprake për marrjen e shërbimit LAN to LAN të vitit 2013, duke mos zbatuar kërkesat e nenit 28/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ku shprehet: “Përcaktimi i vlerës së një kontrate publike bazohet në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH, të përllogaritur nga autoriteti kontraktor në çastin e botimit të njoftimit të kontratës...ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një botim i tillë”. Dhe me kreun II, pika 2, germa “ç” të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet: “Autoriteti kontraktor, në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, analizon koston e mallrave, të shërbimeve dhe punëve që prokurohen.....”.

Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Blerje serveri”**, nxjerrja e urdhrat të prokurimit nënshkruar nga z. ██████████ në formën “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, nuk është e

argumentuar, pasi; në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitin 2013, dërguar në APP me nr. 363/2 prot, datë 5.02.2013, nënshkruar nga titullari, zëri me nr.24 “Përmirësim i sistemit të shërbimit QKR”, është parashikuar “Blerje kompjuter e server” me kod projekti [REDACTED], me fond limit 4,5 milion lekë. Me ndryshimet e bëra në regjistrin e prokurimeve për vitin 2013, dërguar në APP me shkresën nr.4828/1 prot, datë 13.05.2013, ky zë është zëvendësuar me “Pajisje kompjuterike dhe server”. Ndërsa urdhri i prokurimit është nxjerrë vetëm për “blerje serveri” me fond limit prej 3.75 milionë lekë, duke hequr pajisjet kompjuterike, pa ndryshuar fondin limit, duke sjellë si pasojë rritjen artificiale të fondit limit për blerjen e serverit.

Në cilësinë e ish titullarit të QKR-së, ka nënshkruar urdhrat e prokurimit, në të cilat ka mbizotëruar forma e prokurimit “Ftesa me negociim pa botimin paraprak të njoftimit të kontratës”, duke e argumentuar këtë me emergjencën e krijuar për shërbime e mallra. Nga analiza e hollësishme të procedurave të prokurimit të zhvilluara në vitin 2013, u konstatua se, në dokumentet e tenderit, janë vendosur kërkesa kualifikuese të paargumentuara që kanë sjellë dështime të procedurave prokuruese, për të cilët në cilësinë e Titullarit nuk ka marrë masa për eliminimin e parregullsive, për faktin se këto emergjenca janë krijuar në mënyrë artificiale nga vetë Autoriteti Kontraktor.

Ka nënshkruar urdhër shpenzime për blerje mallra dhe materiale më tepër se kërkesat për përdorimin e tyre duke rritur mënyrë të paargumentuar gjendjen e mallrave stok të cilat kapin vlerën **900 mijë lekë**, gjë që tregon për përdorim pa efektivitet të fondeve publike

Ka lejuar që rikuperimi i të dhënave nga serveri i djegur të kryhet nga një subjekt privat dhe jo nga shoqëria që ka lidhur kontratë për mirëmbajtjen e serverit, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën prej **190,000 lekë**.

KONTROLI I LARTË I SHETIT